




## POLITIKA E CILESISE

02	I	Rikodifikim i dokumentit				08.05.2019
01	I	Zgjerim I fushes se aktivitetit				15.11.2017
00	I	Hartimi fillestar				10.03.2013
Rish.	Hartimi	Arsyet e nxjerrjes/rishikimit te ketij dokumenti				Data e nxjerrjes
	Pregatitur	Firma	Kontrolluar	Firma	Aprovuar	Firma
						

## POLITIKA E CILESISE

AQScert ka si detyrë të promovojë dhe të realizojë kërkime për të përmirësuar njohuritë mbi karakteristikat që përcaktojnë cilësitë e proceseve në prodhimet dhe shërbimet e ndryshme të ekonomisë, mbi teknikat dhe metodologjinë e përshtatshme të certifikimit të tyre, mbi eko-kompatibilitetin e proceseve të industrisë agroushqimore dhe të karakteristikave mjedisore të territoreve në të cilat realizohen këto produkte dhe shërbime, mbi testimet laboratorike ne produkte dhe ambient.

Kompetencat dhe njohuritë që AQScert ka arritur në këtë aktivitet, si organizëm, dhe ku pjestarët e stafit të tij tashmë me eksperiencë (dhjetë vjecare), i krijojnë mundësinë të realizojë në mënyrë serioze promovimin e sistemeve të certifikimit të cilësisë së shoqërive të fushave të ndryshme, te realizimit te testimeve laboratorike dhe te inspektimit teknik.

Objektiv kryesor ne aktivitetin e saj AQScert ka:

- **Garantimi i nje vleresimi te paanshem dhe objektiv te klienteve te saj;**
- **Garantimin e nje rezultati testimi te paanshem dhe objektiv.**
- **Promovimi i permiresimit te ambjentit ne pergjithesi dhe i mjedisit te punes ne vecanti ne kompanite kliente;**
- **Vendosjen e sigurise dhe shendetit te punonjesve ne baze te manaxhimit te shoqerive kliente;**
- **Permiresimi i kushteve higjenike dhe i sigurise se produkteve ushqimore dhe joushqimore per shoqerine dhe konsumatorin ne vecanti.**

Në këtë kontekst, AQScert kontribuon për zhvillimin e interesave të shoqërive prodhuese/shërbimi dhe të konsumatorve, të një kulture cilësie, përmes kualifikimeve dhe perditësimeve të operatorëve të fushave të ndryshme duke promovuar rritjen e nje sistemi raportesh tregtare dhe të bashkëpunimit teknik të prodhuesve, shpërndarësve dhe konsumatorëve, të bazuar mbi specifika dhe në sigurimin e garancive dhe të besueshmërisë.

Përmes rritjes se kultures se cilesise, AQScert synon të mbështesë dhe të inkurajojë kompanitë për përmirësim të vazhdueshëm të proceseve të saj dhe konsistencën e karakteristikat e produkteve të tyre, drejtimin dhe vëmendjen për të matur kënaqësinë e klientëve të tyre.

Ndjekja e këtyre objektivave arrihet edhe duke patur marrëdhënie me organizata kombëtare, që operojnë në sektorin e certifikimit të cilësisë.

Si një organ i pavarur, AQScert i siguron qasje të lirë për certifikim, testime laboratorike, inspektime të gjitha bizneseve dhe persnave që aplikojnë, duke u impenjuar që të mos adoptojë politika dhe procedura diskriminuese ose t'i trajtojë ato në një mënyrë diskriminuese. Ky angazhim, së bashku me fshehtësinë e të gjithë informacionit dhe transparencës së procedurave të miratuara janë realizuar në përputhje me standartet ndërkombëtare, evropiane dhe shqiptare që rregullojnë aspekte në veprimtarinë e organizmave certifikues, duke siguruar një nivel të shërbimit dhe formë që mund të njihet në çdo vend.

Paanësia në punën tonë është angazhimi Ynë dhe kontrolli i këtij aspekti është shumë i kërkuar edhe duke ngritur nje komitet të ruajtjes së paanshmërisë dhe të konfliktit të interesave.

Periodikisht AQScert verifikon manaxhimin e rreziqeve të mundshme për paanësinë e saj duke informuar të gjithe subjektet e identifikuar dhe duke i ftuar që të njoftojnë për eventuale pozicioni qe duhet të vleresohen.

Për të qënë kompetente dhe të njihet si e tillë, AQScert ndjek një politikë të specializimit të lartë në sektorin e saj, duke ndjekur aktivitete të standartizimit, duke bashkëpunuar në mënyrë aktive në realizimin dhe zbatimin e udhëzimeve për sektorët e kompetencës së saj, në zhvillim dhe në veçanti trajnimin e personelit të saj, dhe çdo realitet tjetër që ka të bëjë me kulturën e cilësisë dhe te certifikimit.

AQScert për të garantuar paanësinë, nuk angazhohet në ndonjë veprimtari këshilluese në vetvete ose nëpërmjet personelit ose organizatave të lidhura me të, në lidhje me kompanitë që operojnë në fushat e kompetencës së saj të certifikimit.

AQScert siguron dallim midis veprimtarisë së certifikimit, testimit, inspektimit (të përshkruar në Manualet e Cilësisë sipas departamenteve) dhe çdo aktivitet tjetër të kryer në përputhje me objektivat ligjore (studime konsulencë fiskale dhe ligjore).

Për zbatimin e qëllimeve statutore, AQScert përdor ;

- aktivitetet e certifikimit të sistemeve të manaxhimit të shoqërive, aktivitetet e realizimit të testeve laboratorike;
- organizimin dhe pjesëmarrjen në ngjarje, konferenca, kongrese dhe seminare;
- promovimin e studimeve të shumta mbi çështje të veçanta si aktivitetet e trajnimit dhe kualifikimit profesional, në bashkëpunim me agjencitë e tjera.

Ne sektorin e shërbimeve të testimit Laboratori AQSCERT ka si qëllim të vetin të promovojë dhe të sigurojë rezultate analitike të sakta dhe të besueshme.

Si Administrator të paktën çdo vit, do të marrë pjesë në kontrollin e dokumentave të aktiviteteve të verifikimit të realizuara nga AQScert mbi veprimtarinë e tij, dhe konfrontimi me rezultatet me planin e përmirësimit të cilësisë, ku është e mundur me tregues të matshëm.

Si Administrator kam përgjegjësinë për përcaktimin dhe zbatimin e këtyre planeve, të paktën një herë vit, duke vendosur veprimet korrigjuese të nevojshme.

Ankesat dhe kontestimet lidhur me manaxhimin e certifikimit, testimet laboratorike ose ndonjë aktiviteti tjetër që nuk janë zgjidhur duke përdorur strukturat organizative ekzistuese, vendosen nën kujdesin e komiteteve teknike dhe është impenjimi im në ndjekjen dhe përbërjen e tyre.

Tirane, me 15-01-2022

Administrator AQScert

